

Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykata ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.58/2006...96/19), dhe nenit 41 dhe nenit 46 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke diskutuar rreth çështjes se vallë vendim gjyqësor mund të bazohet në rregullë që nuk ekziston në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në momentin e vendimmarrjes (por ka qenë i vlefshëm në momentin e ngritjes së procedurës gjyqësore), respektivisht vallë i njëjti do të ishte e pavlefshëm nëse do të merrej vendim, në seancën e mbajtur më 07.10.219, miratoi siç vijon:

MENDIM JURIDIK

Vendim gjyqësor nuk mund të bazohet në rregullë që nuk ekziston në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në momentin e vendimmarrjes (por ka qenë i vlefshëm në momentin e ngritjes së procedurës gjyqësore), respektivisht i njëjti nuk do të mund të realizohej nëse do të ishte sjellë, por në qoftë se realizimi ka filluar do të ndërpritet.

A r s y e t i m

Sektori i praktikës gjyqësore pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sollti konkluzion që Sektori i veprave civile të shqyrtojë rreth çështjes juridike – se vallë vendim gjyqësor mund të bazohet në rregullë që nuk ekziston në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në momentin e vendimmarrjes (por ka qenë i vlefshëm në momentin e ngritjes së procedurës gjyqësore), respektivisht vallë i njëjti do të ishte i pavlefshëm po qe se merrej vendim, dhe e tërë kjo, me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe zbatimin unik të ligjeve.

Në rastin konkret bëhet fjalë për padi të parashtruar nga Ngrohëtorja SHA kundër konsumatorëve të shkyqur nga energjia termike, ndërsa nga ata kërkon kompensimin sipas Kushteve për furnizimin me energji termike në rajonin e qytetit të Shkupit (neni 52 paragrafi 3) sipas Sistemit tarifor.

Në fakt, bëhet fjalë për padi të parashtruara në momentin kur ende ka pasur vlerë neni 52 paragrafi 3 të Kushteve të theksuara që më parë, ndërsa vendimet gjyqësore janë sjellë pas abrogimit të nenit 52 paragrafi 3 të Kushteve.

Neni 52 paragrafi 3 i Kushteve të furnizimit me energji termike në rajonin e qytetit të Shkupit abroget me vendim të Gjykatës kushtetuese të RM nga 4.2.2009.

Sipas nenit 112 nga Kushtetuta e RM, Gjykata kushtetuese do të abrogojë ose shfuqizojë ligjin nëse konstaton se nuk është në përputhje me Kushtetutën. Gjykata kushtetuese do të abrogojë ose do të shfuqizojë rregullë tjetër ose akt të përgjithshëm, marrëveshje kolektive, statut ose program të partisë politike ose të shoqatës, nëse konstaton se të njëjtat nuk janë në përputhje me Kushtetutën ose me ligjin. Vendimet e Gjykatës kushtetuese janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme.

Sipas nenit 79 të Rregullores së Gjykatës kushtetuese, vendimet e Gjykatës kushtetuese të RM, me të cilin abroget ose shfuqizon ligjin, rregullë ose akt tjetër të përgjithshëm realizon veprim juridik nga dita e botimit në Gazetën zyrtare të RM.

Sipas nenit 80 së të njëjtës Rregullore, realizimi i akteve individuale të formës së prerë të sjellë në bazë të ligjit, rregullës ose akti tjetër të përgjithshëm që me vendim të Gjykatës abrogohet nuk mund të lejohet, as të zbatohet, e as të realizohet.

Sipas nenit 81 paragrafi 3, realizimi i akteve individuale të formës së prerë, të sjellë në bazë të ligjit, rregullës ose akti tjetër të përgjithshëm që me vendimin e Gjykatës kushtetuese është shfuqizuar, nuk mund të lejohet, as të zbatohet, por në qoftë se realizimi ka filluar do të ndërpritet.

Në nenet 79, 80 dhe 81 të Rregullores së Gjykatës kushtetuese, janë dhënë veprimet juridike të vendimeve të Gjykatës kushtetuese, me atë që abrogimi rezulton nga momenti i vendimmarrjes abroguese, që do të thotë se vendimi rezulton nga momenti i abrogimit të tij, ndërsa shfuqizimi rezulton në atë se si ajo dispozitë, respektivisht ligj, rregullë ose akt tjetër i përgjithshëm as që ka ekzistuar.

Në rastin konkret, parashtrohet pyetja e zbatimit kohor të akteve juridike të përgjithshme. Në fakt, nga dispozitat e theksuara që më parë rrjedh se vendimet e Gjykatës kushtetuese me të cilën abrogohet ligj ose akt tjetër i përgjithshëm juridik janë të formës së prerë dhe detyrues për të gjithë, andaj me abrogimin e ndonjë akti të caktuar, i njëjti në praktikë ndalon të vlejë dhe nuk është pjesë e sistemit juridik, dhe me atë nuk mund të paraqesë bazë për sjelljen e akteve individuale në të ardhmen, por as realizimin e akteve individuale të sjellë në bazë të tij, në qoftë se realizimi ende nuk ka përfunduar.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**